

VENDIM
Nr. 35, datë 30.5.2012

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	Anëtar i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“	“
Petrit Plloçi	Anëtar i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare e	“	“
Admir Thanza	Anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	Anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	Anëtar i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 17.04.2012 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore mbi bazë dokumentesh çështjen nr. 8 Akti, që i përket:

KËRKUES: Zharin Divintari

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave Tiranë, Zyra e Përmbarimit Tiranë.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/g, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Berberin, shqyrtoi aktet dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi ka filluar punë në administratën doganore në datën 08.08.1997. Me aktin nr. 6331, datë 11.08.2003, është emëruar kryetar i Degës Detare të Kontrabandës. Mbi bazën e VKM-së nr. 612, datë 11.09.2003 “Për strukturën organike dhe analitike të administratës doganore” kërkuesi është transferuar në detyrën shëf i Sektorit të Antikontrabandës Tokësore dhe ka qëndruar në këtë detyrë deri në daljen e aktit nr. 8201 prot., datë 21.10.2005 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, sipas të cilit ai është liruar nga detyra dhe është lënë në dispozicion të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (DPD) për t’u emëruar në një detyrë tjetër.

2. Ky akt është bërë objekt shqyrtimi administrativ në Komisionin e Shërbimit Civil (KSHC), i cili me vendimin nr. 12, datë 26.01.2006, ka shfuqizuar aktin nr. 8201 prot., datë 21.10.2005, si të pabazuar në ligj dhe ka urdhëruar “kthimin e kërkuesit në vendin e mëparshëm të punës si shëf i Sektorit të Antikontrabandës Tokësore dhe pagimin e pagës për gjithë kohën e qëndrimit pa punë nga ndërprerja e marrëdhënieve financiare”. Ky vendim i KSHC-së është ankimuar nga DPD-ja në Gjykatën e Apelit Tiranë. Në datën 07.03.2006, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave ka nxjerrë aktin nr. 2877 prot., me anë të të cilit ndaj kërkuesit është marrë masa disiplinore e “largimit nga puna”. Edhe ky akt është kundërshtuar nga kërkuesi përpara KSHC-së, i cili me vendimin nr. 437, datë 15.06.2006, ka vendosur shfuqizimin e tij si akt absolutisht i pavlefshëm.

3. Pas ankimit të ushtruar nga DPD-ja, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 184, datë 03.11.2006, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 437, datë 15.06.2006 të KSHC-së.

4. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2007-849, datë 22.06.2007, ka vendosur mospranimin e rekursit me motivacionin se nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 480 të Kodit të Procedurës Civile (KPC).

5. Kërkuesi, me anë të një shkrese, i ka kërkuar Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave të ekzekutojë vendimin nr. 437, datë 15.06.2006 të KSHC-së që është lënë në fuqi nga vendimi nr. 184, datë 03.11.2006 i Gjykatës së Apelit Tiranë, i formës së prerë. Ai ka kërkuar rikthimin në vendin e mëparshëm të punës dhe pagesat përkatëse për kohën e qëndrimit pa punë nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare. Më pas, kërkuesi i ka kërkuar Zyrës së Përmbartimit Tiranë zbatimin e vendimit nr. 437, datë 15.06.2006 të KSHC-së dhe Zyra e Përmbartimit, mbi bazën e kësaj kërkesë, ka nisur procedurat përmbartimore.

6. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (në vijim “Gjykata”), duke pretenduar se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor për arsye të mosekzekutimit të vendimit nr. 437, datë 15.06.2006 të KSHC-së, të lënë në fuqi nga një vendim gjyqësor i formës së prerë. Ai ka argumentuar se është larguar nga puna në mënyrë të paligjshme dhe DPD-ja nuk ka zbatuar detyrimet që buronin nga vendimi i KSHC-së për rikthimin e tij në punë dhe dhënien e pagesave përkatëse.

7. *Subjekti i interesuar*, DPD-ja ka paraqitur me shkrim prapësimet e saj, duke pretenduar se:

7.1 Kërkuesi nuk i ka shteruar mjetet ligjore të ankimit për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, pasi vendimi nr. 12, datë 26.01.2006 i KSHC-së, i cili është i vetmi vendim që ka përcaktuar “rikthimin në punë dhe pagesat përkatëse”, është prishur nga Gjykata e Lartë dhe çështja është kthyer për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë; ndaj vendimit të kësaj gjykate pas rigjykimit kërkuesi nuk ka ushtruar ankim.

7.2 Është parashkruar afati dy vjeçar për paraqitjen e kërkesës në Gjykatën Kushtetuese.

7.3 Pretendimi i kërkuesit është i pambështetur për arsye se i vetmi vendim i formës së prerë ka disponuar shfuqizimin e aktit të administratës doganore për largimin nga puna, ndaj, në këto kushte, nuk ekziston ndonjë detyrim për t’u ekzekutuar nga administrata doganore.

II

A. Për pretendimin e moslegjitimit të kërkuesit si pasojë e mosshterimit të mjeteve ligjore

8. Subjekti i interesuar, DPD-ja, ka pretenduar se kërkuesi nuk i ka shteruar mjetet ligjore të ankimit për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, në lidhje me cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Ky cenim, sipas kërkuesit, ka ardhur si pasojë e mosekzekutimit të vendimit të formës së prerë nr. 184, datë 03.11.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë, që ka lënë në fuqi vendimin nr. 437, datë 15.06.2006 të KSHC-së, duke detyruar administratën doganore ta rikthejë kërkuesin në vendin e mëparshëm të punës dhe t’i paguajë pagën për kohën e qëndrimit pa punë nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare.

9. Gjykata është shprehur në jurisprudencën e saj se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i një vendimi të formës së prerë të gjykatës është pjesë përbërëse e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të Kushtetutës dhe të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“KEDNJ”) (*shih vendimin nr. 6, datë 07.03.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas Gjykatës, ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të të drejtës e të vetë nocionit të gjykitimit të drejtë. Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individ i ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Në këtë fazë duhet të marrin pjesë aktivisht jo vetëm palët, pra debitori dhe kreditori, por edhe organet kompetente të ngarkuara me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë (*shih vendimet nr. 6, datë 06.03.2009; nr. 1, datë 19.01.2009; nr. 43, datë 19.12.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Nga shqyrtimi i dokumenteve të paraqitura dhe parashtrimeve me shkrim të subjektit të interesuar, DPD-së, Gjykata konstaton se kërkuesi ka qenë palë në tre procese gjyqësore të veçanta që lidhen me largimin e tij nga puna si Shef Sektori i Antikontrabandës Tokësore në administratën doganore.

i) *Procesi në lidhje me aktin administrativ nr. 8201, datë 21.10.2005 (vënia e kërkuesit në dispozicion)*

11. Kërkuesi, me aktin administrativ nr. 8201 prot. datë 21.10.2005 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, është liruar nga detyra dhe është lënë në dispozicion të DPD-së. Kjo ka ndodhur për arsye të shkurtimit të vendit të punës në bazë të VKM-së nr. 686, datë 02.11.2005 “Për disa ndryshime dhe shtesa

në VKM 205, datë 13.04.1999”. Ky akt administrativ është kundërshtuar nga kërkuesi në KSHC, i cili, nëpërmjet vendimit nr. 12, datë 26.01.2006, ka vendosur “shfuqizimin e aktit nr. 8201 prot., datë 21.10.2005, si të pabazuar në ligj duke urdhëruar kthimin e kërkuesit në vendin e mëparshëm të punës si shef i Sektorit të Antikontrabandës Tokësore; dhe pagimin e pagës për kohën e qëndrimit pa punë nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në zbatimin e këtij vendimi”. DPD-ja ka ushtruar të drejtën e ankimit në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila, me vendimin nr. 80, datë 27.06.2006, ka lënë në fuqi vendimin nr. 12, datë 26.01.2006 të KSHC-së. Ndaj këtij vendimi DPD-ja ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë e cila, me vendimin nr. 183, datë 07.05.2009, ka vendosur prishjen e vendimeve nr. 80, datë 27.06.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr. 12, datë 26.01.2006 të KSHC-së dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo e fundit, me vendimin nr. 7966, datë 07.10.2009, ka vendosur pushimin e gjykimit. Kërkuesi, për vënien në zbatim të vendimit nr. 12, datë 26.01.2006 të KSHC-së, i është drejtuar Zyres së Përmbarrimit Tiranë. Fillimisht, me shkresën nr. 4576, datë 07.05.2007 Zyra e Përmbarrimit i ka dërguar DPD-së “lajmërim për ekzekutim vullnetar” të urdhrit të ekzekutimit nr. 111, datë 15.03.2007 të Gjykatës së Apelit Tiranë për zbatimin e vendimit nr. 12, datë 26.01.2006 të KSHC-së. Më tej, Zyra e Përmbarrimit ka marrë vendim për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm, por pasi është vënë në dijeni në lidhje me vendimin e Gjykatës së Lartë për kthimin e çështjes për rigjykim dhe prishjen e vendimit nr. 12, datë 26.01.2006 të KSHC-së, ka vendosur pushimin e urdhrit të ekzekutimit nr. 111, datë 15.03.2007.

ii) *Procesi në lidhje me aktin administrativ nr. 2877, datë 07.03.2006 (largimi i kërkuesit nga puna)*

12. Me aktin administrativ nr. 2877 prot., datë 07.03.2006 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, kërkuesi është larguar nga puna dhe ndaj këtij akti ai ka paraqitur ankim në KSHC. Pasi ka konstatuar se akti i largimit të kërkuesit nga puna është absolutisht i pavlefshëm, me vendimin nr. 437, datë 15.06.2006, KSHC-ja ka vendosur shfuqizimin e aktit nr. 2877 prot. datë 07.03.2006 si të pabazuar në ligj. DPD-ja ka ushtruar të drejtën e ankimit kundër vendimit të KSHC-së në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila, me vendimin nr. 184, datë 03.11.2006, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 437, datë 15.06.2006 të KSHC-së. Ndaj këtij vendimi DPD-ja ka ushtruar të drejtën e rekursit dhe Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit.

iii) *Procesi në lidhje me padinë e re të paraqitur nga kërkuesi për zbatimin e vendimit nr. 437, datë 16.06.2006 të KSHC-së*

13. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë përmes një kërkesëpadie të re, duke kërkuar zbatimin e vendimit nr. 437, datë 15.06.2006 të KSHC-së, rikthimin në punë dhe pagesën e pagave nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve të punës pa shkaqe të arsyeshme. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në bazë të nenit 179/1 të Kodi të Procedurës Civile (KPC), me vendimin nr. 128, datë 23.02.2011 ka vendosur pushimin e gjykimit.

14. Nga aktet e mësipërme, Gjykata vlerëson se, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, kërkuesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Sipas parashikimit të këtij neni, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, *pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave*. Rregulli i vendosur nga dispozita e mësipërme kushtetuese e detyron kërkuesin, që për zgjidhjen e çështjes së tij, t’iu drejtohet të gjitha instancave gjyqësore të zakonshme përpara se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Kërkuesi legjitimohet vetëm kur shteron mjetet e ankimit pranë gjykatave të sistemit gjyqësor. Shterimi nënkupton që kërkuesi duhet t’i shfrytëzojë, në shkallët e sistemit gjyqësor, të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 8, datë 28.02.2012; nr. 17, datë - 16.05.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjykata vëren se vendimi nr. 12, datë 26.01.2006 i KSHC-së, i cili është i vetmi vendim që ka përcaktuar në dispozitiv rikthimin në punë të kërkuesit dhe dhënien e pagesave përkatëse, është prishur nga Gjykata e Lartë dhe çështja është rikthyer për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo e fundit ka vendosur pushimin e çështjes dhe ky vendim ka marrë formë të prerë, duke filluar nga data

12.10.2009, për shkak se kërkuesi nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj tij. Për pasojë, nga momenti që vendimi për pushimin e çështjes ka marrë formë të prerë, ka rënë dhe pretendimi i kërkuesit për rikthim në punë apo pagimin e pagës për kohën e qëndrimit pa punë. Megjithatë, tre vjet më vonë kërkuesi, duke u bazuar te vendimi nr. 437, datë 15.06.2006 i KSHC-së, ka kërkuar sërish rivendosjen e së drejtës për rikthim në punë dhe pagesat përkatëse me anë të një padie të re. Sipas akteve të administruara të dosjes gjyqësore rezulton se vendimi nr. 437, datë 15.06.2006 i KSHC-së, te i cili kërkuesi mbështet pretendimet e tij, është një vendim deklarativ që ka shfuqizuar si absolutisht të pavlefshëm vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave për largimin nga puna të kërkuesit dhe nuk disponon për rikthimin në punë të tij apo dhënien e pagesave përkatëse nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare. Për më tepër, ky vendim nuk shprehet as mbi rregullimin e pasojave që rrjedhin nga shfuqizimi i aktit administrativ të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave. Mbi padinë e re Gjykata e Rrethit Gjyqësor

Tiranë ka vendosur pushimin e gjykimit dhe përsëri kërkuesi nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj këtij vendimi.

16. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se kërkuesi, duke mos ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimeve gjyqësore, mbi bazën e të cilave kërkon rivendosjen në vend të së drejtës së cenuar, nuk i ka shteruar të gjitha mjete juridike në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës.

17. Përfundimisht, në çështjen objekt shqyrtimi, Gjykata arrin në konkluzionin se kërkuesi nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, për arsye të mosshterimit të mjeteve ligjore.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/f e 134/g të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Admir Thanza, Vitore Tusha, Petrit Pllloçi, Sokol Berberi, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj.